




513/17

24.04.2017



## MEMORANDUM MIRËKËPTIMI

në mes të

### Komunës së Vushtrrisë dhe Demokraci Plus (D+)

#### Qëllimi i Memorandumit

Me qëllim të artikullimit të kërkesave të qytetarëve për përmirësim të shërbimeve publike nën përgjegjësi komunale përmes platformave elektronike, Komuna e Vushtrrisë dhe Demokraci Plus (D+) përmes këtij memorandumi shprehin vullnetin për të bashkëpunuar në pikat e mëposhtme:

1. Funksionalizimin e platformës elektronike ndreqe.com (nga këtu 'platforma') për të mundësuar angazhimin e qytetarëve të Vushtrrisë në përmirësimin e shërbimeve publike në lagjen dhe fshatrat e tyre;
2. Komunikimin konstruktiv dhe angazhimin për të zgjidhur kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të shtruar përmes platformës;
3. Informimin e qytetarëve për statusin e veprimeve të ndërmarra pas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në platformë.

#### Përgjegjësitë e D+:

Përmes këtij memorandumi, për të arritur synimet e lartëpërmendura, D+ zotohet të:

- Ndërtojë, promovojë dhe mirëmbajë në mënyrë të paanshme politike një platformë që do të mund të shërbej si medium për qytetarët e Vushtrrisë që të raportojnë problemet me shërbimet publike në lagjet apo fshatrat e tyre;
- Informojë në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme zyrtarët komunal për raportimet e qytetarëve në platformë. Më tutje të ofrojë hartat digjitale të komunës së Vushtrrisë që saktësojnë çfarë kërkesa/ankesa janë raportuar dhe lokacionin e saktë në hartë digjitale;
- Promovojë numrat telefonikë gratis të komunës në platformë ku qytetarët mund të marrin informata më të detajueshme për shërbimet publike;
- Ofrojë lehtësimin e komunikimit të komunës me qytetarët aktiv në platformë;
- Nëse është e nevojshme asistencë teknike për zyrtarët komunal se si të përdoren platformat elektronike.

#### Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë

Përmes këtij memorandumi, për të arritur synimet e lartëpërmendura, Komuna e Vushtrrisë zotohet të:

- Të angazhohet për trajtim të kërkesave dhe raportet e qytetarëve në lidhje me shërbimet publike komunale të shtruar përmes platformës;
- Bëjë përpjekje që të zgjidh në kohë sa më të shkurtë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve sipas mundësive kohore dhe buxhetore;


- Vë në gatishmëri resurset komunale që i kanë nën menaxhim për t'u përgjigjur kërkesave të administratorëve të platformës për gjendjen e kërkesave dhe ankesave të shtruara përmes platformës;
- Promovojë përdorimin e platformave tek drejtuesit e institucioneve komunale në mënyrë që të shërbej për ndërlidhje më të ngushtë me qytetarët aktiv të komunës.
- Të caktojë një zyrtar komunal si pikë kontaktuese për Demokraci Plus për realizimin e kësaj iniciative;
- Të sigurojë që zyrtarët komunal marrin pjesë në punëtoritë (sesione informuese mbi atë se si funksionojnë platformat) e paraparë nga Demokraci Plus.


Komuna e Vushtrisë dhe D+ pajtohen të mbajnë raporte konstruktive të ndërsjellët gjatë këtij bashkëpunimi dhe të respektohet pavarësia dhe paanshmëria politike e D+ si organizatë jo-qeveritare.

Ky memorandum do të hyjë në veprim në mënyrë të menjëhershme dhe të jetë efektiv për një kohë të pacaktuar. Memorandumi mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e dy palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.

Kryetari i Komunës  
Komuna e Vushtrisë

Përfaqësuesi  
Demokraci Plus (D+)

**Bajram Mulaku**  
  
 Datë:  
24.04.2017

**Driton Selmanaj**  
  
 Datë:  
24.04.2017  
